



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS - TUŽILADKI SAVET KOSOVA
SEKRETARIATI - SEKRETARIJAT
ARKIVA - ARHIVA

Pranuar 02-08-2023 Prilijeno

Numri rendor Redni broj	Ora e pranimit Ças prijema	Nenshkrimi i pranuesit Potpis primaoca
1185		



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës -Tužilački Savet Kosova – Kosovo Prosecutorial Council

MEKANIZMI I RAPORTIMIT
TË KRYEPROKURORËVE TË PROKURORIVE THEMELORE
NË KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS

PJESA E PËRGJITHSHME: <i>Kujtim Mumishi</i>		Prokuroria Themelore - Prishtinë		Prill-Qershor/2023															
Enri, mbiemri Kryeprokurorit		Prokuroria		Periudha raportimit		Nënshkrimi													
Numri i prokurorëve dhe stafit administrativ në prokurori:		Kryeprokurori:		1	Administratori:			1											
		Nr. i prokurorëve në DKR:		16	Bashkëpunëtorë profesional:			38											
		Nr. i prokurorëve në DM:		5	Zyrtar ligjor:			46											
		Nr. i prokurorëve në DP:		30	Stafi tjetër:			50											
		Totali:		52	Totali:			135											
A) Numri i kallëzimeve penale të pranuar:		B) Numri i kallëzimeve penale të proceduara (zgjidhura/kryera):		C) Përqindja e rasteve të proceduara (B%A)		D) Ngarkesa me lëndë													
3.658		2.832		77.42%		52.003													
Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga prokurori:	Aktakuza të ngritura:	Hudhje të kallëzimit penal:		Pushim i hetimeve:		Mënyrë tjetër:													
	1. 304	238		103		1.187													
Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga gjykata:	Aktakuza të hudhura:(par ashkrim)	Aktakuza të refuzuara		Aktgjykime liruese		Aktgjykimi dënues													
	599	9		18		1327													
Ankesa kundër aktgjykimit					Ankesa kundër aktvendimit														
Të aprovuara					Të refuzuara														
4					10														
Të aprovuara					Të refuzuara														
6																			
Arritshmëria e normës orientuese të prokurorëve, për periudhën kohore të raportimit:																			
Departamenti për Krime të Rënda:				%	6 raste në muaj është norma e prokurorit në DKR,														
Departamenti për të Mitur:				%	10 raste në muaj është norma e prokurorit në DM,														
Departamenti i Përgjithshëm:				%	23 raste në muaj është norma e prokurorit në DP,														
Arritshmëria e normës në Prokurori:				%	Mesatarja (3/1) e përqindjet në prokurori														
Performanca e prokurorisë në luftimin e Korrupsionit (Paditë Penale 'PP'). Shëno të dhënat në tabelë:																			
Raste të pranuar;		Raste të kryera:		Ngarkesa me raste:		Hudhje		Pushim		Janë ngritur Aktakuza		Aktakuz a hudhura		Aktakuza të refuzuara		Aktgjykim e liruese		Aktgjykim i dënues	
R ¹	P ²	R	P	R	P	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona
69	160	57	132	177	473	40	35	20						4				7	
Performanca në sekustrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme. Shëno të dhënat në tabelë:																			

¹ 'R' -nënkupton rastet (kallëzimet penale)

² 'P' - nënkupton personat në kallëzime penale

Kërkesa të aprovuara për dhënie e urdhrave për sekuestrim të përkohshëm	Kërkesa të aprovuara për konfiskimin e pasurisë dhe mjeteve financiare	Kërkesa të aprovuara për dhënie e aseteve në shfrytëzim të qeverisë	Kërkesa të aprovuara për dhënie e aseteve në administrim të AAPSK	Kërkesa për kompensimin e palës së dëmtuar nga mjetet e konfiskuara
13				

I. POLITIKAT DHE PRIORITETET E SISTEMIT PROKURORIAL:

1	<p>Niveli i organizimit, menaxhimit, administrimit dhe funksionimit të prokurorisë? Komento:</p> <p>Zyra e Kryeprokurorit të PTH në Prishtinë ka funksionuar çdo ditë me orar të plotë të punës. Kryeprokurori ka organizuar dhe mbajtur kolegji me rregullta (periodike) me prokurorët e tri Departamenteve në baza 2 javore, dhe disa here gjate javës sidomos me prokurorët e Njësitit për Krime Ekonomike dhe Korrupsion.</p> <p>Gjatë periudhës raportuese, prill-qershor të vitit 2023, organizimi dhe menaxhimi i funksionit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë ka qenë në nivel të kënaqshëm.</p> <p>Gjatë gjithë periudhës raportues, Kryeprokurori ka qenë i angazhuar maksimalisht në rritjen e resurseve humane si dhe rritjen e kualitetit të punës, sidomos në Njësitin për Krime Ekonomike dhe Korrupsion, ku në kuadër të këtij Njësitit me qëllim të organizimit të procesit të punës janë avancuar pesë (5) prokuror/e.</p> <p>Tutje, Kryeprokurori, ka qenë i gatshëm gjithmonë që të presë në konsultime prokurorët dhe hetuesit dhe të bashkëpunojë me ta për raste më të ndërlikuara. Përveç kësaj, kujdestaritë në të gjitha departamentet kanë funksionuar në nivel shumë të mirë dhe reagimi i prokurorëve kujdestarë, përgjithësisht ka qenë i shpejtë dhe efektiv në trajtimin e rasteve të paraqitura.</p> <p>Bazuar në nenin 156 të KPPRK-së, si dhe Udhëzuesin Administrativ të U.D/ Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi si dhe në Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Funksionimin e Prokurorit të Shtetit të Kosovës,, Kryeprokurori ka deleguar disa nga kompetencat e tij tek Udhëheqësit e Departamenteve, si dhe ka vlerësuar lëndët për të cilat prokurorët kanë vendosur që ti hudhin, pezullojnë apo të i pushojnë hetimet.</p> <p>Gjatë kësaj periudhe janë caktuar edhe dy koordinator për shkak se prokurorët që kanë pasur ato pozita janë avancuar, Koordinatorin për Dhunë në Familje, si dhe Koordinatorin për veprat penale kundër Integritetit Seksual, gjithashtu është caktuar edhe një Koordinator i ri për Armë.</p> <p>Përveç kësaj, gjatë periudhës raportuese, Kryeprokurori ka dalur disa herë në vendin e ngjarjes në rastet më të ndërlikuara me qëllim të ofrimit të ndihmës prokurorit përkatës.</p> <p>Nga prokurorët kujdestarë është kërkuar raport me shkrim lidhur me mbarëvajtjen e kujdestarisë në mënyrë që të vazhdohet kronologjia e rasteve me hetuesit kompetent të rasteve si dhe të mbajnë të informuar Udhëheqësin e Departamentit përkatës, si gjatë kujdestarisë edhe pas çdo përfundimit të kujdestarisë. Gjithashtu nëse kujdestaria ka përfunduar në ditën kur është mbajtur kolegji, prokurori përkatës ka raportuar në kolegji lidhur me kujdestarinë në prezencë të prokurorëve, Kryeprokurorit, dhe Udhëheqësit të Departamentit.</p> <p>Tutje, gjatë kësaj periudhe raportuese për shkak të mungesës së prokurorëve në Departamentin për Krime të Rënda, me qëllim të organizimit të punës në këtë departament, Kryeprokurori ka marrë vendim që për një periudhë rreth dy (2) mujore, edhe prokurorët e Njësitit për Krime Ekonomike dhe Korrupsion, përfshirë edhe Udhëheqësin e Departamentit për Krime të Rënda, ta marrin kujdestarinë.</p> <p>Zyra e Kryeprokurorit në vazhdimësi pranon shikresa dhe kërkesa të ndryshme nga palët e interesuara të cilat trajtohen në afate optimale.</p>
---	--

Kryeprokurori, ka të caktuar një ditë gjatë javës në të cilën i pret në takim palët e interesuara.

Cjftshashtu në nivel të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, organizon takime me institucione të ndryshme etj.

Struktura organizative e PTH në Prishtinë është si vijon:

- Kryeprokurori, si udhëheqësi më i lartë i institucionit,
- Departamenti i Krimeve të Rënda - pesëmbëdhjetë (15) prokurorë prej tyre nëntë (9) prokuror janë në Njësitin për Krime Ekonomike dhe Korrupsion.
- Departamenti për të Mitur - pesë (5) prokurorë,
- Departamenti i Përgjithshëm - tridhjetë (30) prokurorë.

Po ashtu, në kuadër të Prokurorisë janë themeluar dy njësite të veçanta, të cilat trajtojnë lëndë të natyrës më specifike, dhe atë:

- Njësitin për Krime Ekonomike dhe Korrupsion;
- Njësitin për trajtimin e rasteve të Dhunës në Familje;

Përveç kësaj, janë caktuar prokurorët si koordinatorë për vepra penale të caktuara, ashtu që:

1. *Koordinator për rastet e Dhunës në familje* është caktuar prokurorja Mimoza Shala,
2. *Koordinator për veprat penale të Narkotikëve* është caktuar prokurori Besnik Jakupi,
3. *Koordinator për procedurën e Bashkëpunimit Juridik Ndërkombëtarë* nga Departamenti i Krimeve të Rënda është caktuar prokurori Armend Hamiti ndërsa nga Departamenti i Përgjithshëm është caktuar prokurori Blerim Igrishta,
4. *Koordinator për veprat penale të Trafikimit me Qenie Njerëzore* është caktuar prokurori Ilaz Beqiri,
5. *Koordinator për procedurën e Sekuestrimit dhe Konfiskimit* është caktuar prokurori Bekim Kodraliu, nga radhët e Departamentit, të Krimeve të Rënda është caktuar prokurori Bashkim Zeqaj.
6. *Koordinator për rastet e krimeve kibernetike*, është caktuar prokurori Arianit Salihu.
7. *Koordinatorë për rastet e Integritetit Seksual*, është caktuar prokurorja Sebahate Hoxha-Pepaj.
8. *Koordinator për rastet e Mbrojtjes së Ambientit* është caktuar prokurori Besart Mustafa.
9. *Koordinator për rastet e KHAIA* është caktuar prokurori Bekim Kodraliu.
10. *Prokurore kontaktuese për rastet e piraterisë* është caktuar prokurorja Elza Bajrami.
11. *Koordinator për raste e Armëve*, është caktuar prokurori Arben Hoti.

Mbështetur në Rregulloren për organizimin e brendshëm të Prokurorit të Shtetit, Administrata ka këtë strukturë organizative:

- Administratori/ja;
- Udhëheqësi i Sektorit të Shkrimore;
- Bashkëpunëtorët profesional;
- Zyrtarët ligjorë;
- Sekretarët juridikë;
- Referentët;

	<ul style="list-style-type: none"> - Arkivistët; - Përkthyesit; - Fletëdorëzuesit; - Receptionsistët; - Vozitësit;
2	<p>Çështjet e avancimit dhe transferimit të prokurorëve? Komento:</p> <p>Gjatë periudhës raportuese janë avancuar pesë (5) prokuror nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për Krime të Rënda, konkretisht në Njësitin për Krime Ekonomike dhe Korrupsion.</p>
3	<p>Çështjet e përgjegjësisë disiplinore të prokurorëve apo stafit mbështetës? Komento:</p> <p><u>Për prokuror:</u></p> <p>AD.nr.11/2023, rast i iniciuar nga pala, ndërsa me dt.03.05.2023 është marrë Vendim për refuzim, të ankesës.</p> <p>AD.nr.12/2023, rast i iniciuar nga pala, ndërsa me dt. 10.05.2023 është marrë Vendim për refuzim, të ankesës</p> <p>AD.nr. 13/2023, rast i iniciuar nga pala, ndërsa me dt.03.05.2023 është marrë Vendim për refuzim, të ankesës.</p> <p>AD.nr. 14/2023, rast i iniciuar nga pala ku rasti është pezulluar.</p> <p>AD.nr. 15/2023, rast i iniciuar sipas detyrës zyrtare, ndërsa me dt. 08.05.2023 është marrë Vendim për iniciimin e procedurës disiplinore.</p> <p>AD.nr. 16/2023, rast i iniciuar nga pala, ndërsa me dt. 08.05.2023 është marrë Vendim për refuzim të ankesës.</p> <p>AD.nr. 17/2023, rast i iniciuar sipas detyrës zyrtare, ndërsa me dt. 08.05.2023 është marrë Vendim për refuzim të ankesës.</p> <p>AD.nr. 18/2023, rast i iniciuar nga pala, ndërsa me dt.29.05.2023 është marrë Vendim për refuzim të ankesës.</p> <p>AD.nr. 19/2023, rast i iniciuar nga pala, ndërsa me dt.12.06.2023 është marrë Vendim për refuzim të ankesës.</p> <p>AD.nr. 20/2023, rast i iniciuar nga pala, ndërsa me dt.22.06.2023 është marrë Vendim për refuzim të ankesës.</p> <p>AD.nr. 21/2023, rast i iniciuar nga pala, ndërsa me dt.22.06.2023 është marrë Vendim për refuzim të ankesës.</p> <p>AD.nr. 22/2023, rast i iniciuar nga pala, ndërsa me dt.18.07.2023 është marrë Vendim për refuzim të ankesës.</p> <p>AD.nr. 23/2023, rast i iniciuar nga pala, ndërsa me dt.18.07.2023 është marrë Vendim për refuzim të ankesës.</p> <p><u>Për staf:</u></p>

	Një (1) procedurë disiplinore dhe (2) vërejtje me shkrim.
4	<p>Çështjet e vlerësimit të punës së prokurorëve përfshirë mospajtimet e prokurorëve? Nivelet e vlerësimit të prokurorëve si dhe tejkalimi kuotës 20% të dalluar? Komento:</p> <p>Gjatë kësaj periudhe raportuese janë realizuar vetëm vlerësimet dhe diskutimet 6 mujore, në të cilat prokurorët vetëm këshillohen.</p>
5	<p>Çështjet e rasteve të ndërlikuara dhe vendimet nga Kryeprokurori për njohjen e këtyre rasteve ? Komento:</p> <p>Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi pasur vetëm një rast të referuar nga ana e prokurorëve që të i njihet sipas Udhëzimit Administrativ nr.01/2018 rast i ndërlikuar, mirëpo kjo kërkesë është refuzuar për shkak se nuk janë plotësuar kushtet që e njëjta të llogaritet si lëndë e tillë.</p>
6	<p>Ankesat ndaj shqiptimit të sanksionit penal të shqiptuar (<i>Udhëzimi i Kryeprokurorit të Shtetit mbi rolin dhe kontributin e prokurorit të shtetit në matjen e dënimit</i>) ? Komento:</p> <p>Në vazhdimësi prokurorët paraqesin ankesa për të gjitha rastet kur ata konsiderojnë se sanksioni penal i shqiptuar nuk përkon me peshën e veprës penale.</p>
7	<p>Zbatimi i politikave, standardeve dhe udhëzimeve sa i përket trajnimit të prokurorëve dhe personelit? Cilat janë kriteret e përzgjes së prokurorëve mentorë për prokurorët fillestar? Komento:</p> <p>Gjatë periudhës raportuese nuk janë caktuar mentor, por në rastet kur caktohen kërkohen të jenë prokurorë me mandat të përhershëm në departamentin e përgjithshëm, të jenë kreativ në hartimin dhe përdorimin e metodologjisë në zbatimin e programit të monitorimit përmes ofrimit të një plani të detajuar të programit praktik; Të kenë treguar performancë të mirë si prokurorë; Të jetë nga radhët e Departamentit të Përgjithshëm; Të jetë në moshë më të re në mënyrë që të jenë më aktiv në bartjen e njohurive profesionale.</p>
8	<p>Niveli i zbatimit të Kodit të Etikës profesionale për prokurorë dhe stafin administrativ? Komento:</p> <p>Në Prokurorinë Themelore në Prishtinë prokurorët i respektojnë të gjitha standardet e sjelljes konform Kodit të Etikës, si brenda ashtu edhe jashtë zyrës dhe kjo reflektohet pozitivisht në veprimtarinë e tyre profesionale. Përrjashtëmish, për prokurorët të cilët ka pasur pretendime se nuk e kanë respektuar.</p>
9	<p>Niveli i pavarësisë së prokurorëve që të veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme gjatë kryerjes së funksioneve prokuroriale? Komento:</p> <p>Prokurorët janë plotësisht të pavarur në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tyre.</p>
10	<p>Zbatimi i politikave të KPK dhe ZKPSH, në luftimin e kriminalitetit për veprat penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional ? Komento:</p> <p>Përgjatë periudhës së raportimit, një theks i veçantë i është dhënë ndjekjes penale të veprave karakteristike. Në kolegjiunet e mbajtura, shpeshherë këto vepra penale kanë qenë temë diskutimi dhe prokurorët janë udhëzuar që t'i trajtojnë me prioritet këto kategori të lëndëve.</p> <p>Sa i përket regjistrin të lëndëve me kryerës të njohur PP, në PTH në Prishtinë, janë të dhënat si në vijim:</p>

Armët - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 22 raste të pazgjidhura. Për këtë kategori të veprave penale, rëndësi i është dhënë caktimit të kompetencës së rasteve ndërmjet Departamentit të Përgjithshëm dhe Departamentit për Krime të Rënda.

Drogat - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 761 raste të pazgjidhura, ndërsa janë zgjidhur 57 lëndë. Për herë të parë, për këtë kategori të veprave penale, një (1) prokuror është caktuar koordinator. Koordinatori përcjellë çështjet penale lidhur me narkotikët, mban evidencë për numrin e rasteve, mbështet prokurorët tjerë më këshilla sipas nevojës, njofton sipas kërkesës Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit lidhur më këto raste, si dhe merr pjesë në takime, seminare apo trajnime lidhur me këto raste, duke respektuar udhëzimet e Kryeprokurorit të Shtetit. Koordinatori po ashtu do të ofrojë bashkëpunim dhe koordinim me mekanizma ndërinstytucionalë dhe ndërkombëtarë, me qëllim të rritjes së efikasitetit në luftimin e narko-kriminalitetit dhe ndjekjes së kryerësve të këtyre veprave penale. Sipas nevojës, Koordinatori do t'i ofrojë bashkëpunim Koordinatorit Nacional kundër Narkotikëve.

Korrupsioni - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 250 raste të pazgjidhura, ndërsa janë zgjidhur 50 lëndë.

Krimet ekonomike - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 225 raste të pazgjidhura, ndërsa janë zgjidhur 12 lëndë.

Trafikimi me njerëz - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 8 raste të pazgjidhura, ndërsa është zgjidhur 2 lëndë. Për këtë kategori të veprave penale, një (1) prokuror është caktuar koordinator. Koordinatori për rastet e trafikimit me qenieve njerëzore përcjell rastet e trafikimit më njerëz, mban evidencë për numrin e rasteve, mbështet prokurorët tjerë më këshilla sipas nevojës, njofton sipas kërkesës Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit lidhur më këto raste, si dhe merr pjesë në takime, seminare apo trajnime lidhur më këto raste, duke respektuar udhëzimet e Kryeprokurorit të Shtetit.

Kontrabandimi me migrant - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 29 raste të pazgjidhura, ndërsa është zgjidhur një lëndë.

Nxitja e urrejtjes - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 4 raste të pazgjidhura.

Sa i përket regjistrimit të lëndëve me kryerës të njohur PPN, në PTH në Prishtinë, janë të dhënat si në vijim:

Drogat - në fund të periudhës raportuese, gjithsej ka mbetur 2 raste të pazgjidhur.

Korrupsioni - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 525 raste të pazgjidhura, ndërsa janë zgjidhur 36 lëndë.

Krimet ekonomike - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 66 raste të pazgjidhura, ndërsa janë zgjidhur 3 lëndë.

Trafikimi me njerëz - në fund të periudhës raportuese, gjithsej ka mbetur 0 rast i pazgjidhur.

Kontrabandimi me migrant - në fund të periudhës raportuese, është zgjidhur 0 rast.

11	<p>Niveli i zbatimit të kërkesave nga Komionet e Përhershme të Këshillit dhe nga vet KPK-ja? Komento:</p> <p>Të gjitha kërkesat e adresuara nga KPK-ja janë zbatuar përpikërisht dhe brenda afateve.</p>
12	<p>Performanca e prokurorëve në përdorimin e sistemit SMIL ? Komento:</p> <p>Gjatë kësaj periudhe raportuese nuk janë përditësuar vlerësimet e performancës së prokurorëve në SMIL, mirëpo të gjatë prokurorët janë obliguar nga Kryeprokurori që të rrisin nivelin se aftësimin në përdorim të</p>

	SMIL, duke i njoftuar se tani e tutje për çdo mospërputhje mes statistikave në SMIL si dhe atyre të dorëzuara në Shkrimore, përgjegjësini do ta mbajnë prokurorët pasi që si raport përfundimtar do merret raporti i nxjerr nga SMIL.
	<p>Sfidat apo të arriturat: Komento:</p> <p>Sfiduese gjatë kësaj përudhë ka qenë numri i vogël i prokurorëve Në Departamentin për Krime të Rënda dhe Departamentin për të Mitur, lidhur me këtë Kryeprokurori ka parashtruar disa herë kërkesa në Këshillin Prokurorial të Kosovës.</p> <p>Si e arritur mund të theksohet performanca shume e mire e prokuroreve në raport me lëndë të kryera.</p>

I. ZBATIMI I OBLIGIMEVE SIPAS PLANIT TË PUNËS TË PROKURORISË SË SHITETIT

1	<p>Objekti 1: Rritja e efikasitetit në trajtimin e rasteve penale me prioritet. Komento:</p> <p>Kryeprokurori çdo dy javë mban kolegji me prokurorët e dep. Përgjithshëm dhe me prokurorët e dep. Krime të Rënda dhe dep. për të Mitur, po ashtu vazhdimisht kërkon nga të gjithë që këtë vit të punojnë edhe më shumë, në mënyrë që të tregojnë efikasitet, të rrisim besimin e publikut, të bashkëpunojnë së bashku, e nëse duhet ndihmë të formohen grupe punuese në mënyrë që lëndët të trajtohen me kohë dhe në mënyrë sa më profesionale.</p> <p>Për nevoja të forcimit të departamentit të Krimeve të Rënda kemi kërkuar të shtohet numri i prokurorëve në këtë departament.</p> <p>Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Kujtim Munishi, mban takime të rregullta në baza mujore dhe ditore me përfaqësues të Policisë së Kosovës, Hetuesisë, Inspektoratit Policor, si dhe akter ndërkombëtar me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional dhe diskutimit për rritjen e efikasitetit në trajtimin e rasteve penale.</p>
2	<p>Objektivi 2: Fuqizimi i besimit të publikut në punën e Prokurorit të Shtetit. Komento:</p> <p>Zyra për komunikim në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, gjithnjë është duke synuar ta aplikojë komunikimin proaktiv me medime dhe gazetarë, përmes ndërtimit dhe përmirësimit të një kulture të brendshme komunikimi me prokurorë të të gjitha departamenteve të kësaj prokurorie.</p> <p>Gjatë periudhës Prill-Qershor 2023, Prokuroria Themelore në Prishtinë ka hartuar në baza ditore Raportin 24 orësh dhe i njëjti i është dërguar Zyrës për Informim në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, dhe atë në kohë reale.</p> <p>Gjithashtu, kjo prokurori ka hartuar dhe lëshuar për media gjithsej 6 komunikata/njoftime/sqarime dhe aktivitete që janë realizuar brenda saj, ka pranuar 180 pyetje, është përgjigjur në 150 kërkesa, po ashtu ka ofruar qasje në 6 kërkesa të parashtruara me bazë në Ligjin për Qasje në Dokumente publike.</p> <p>Nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, përgjatë kësaj periudhe janë dhënë gjithsej 8 prononcime për Televizionet vendore, lidhur me çështje të ndryshme penale, në interes për opinionin e gjerë.</p>
3	<p>Objekti 3: Rritja e shkallës së sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar të aseteve të fituara me vepër penale. Komento:</p> <p>Në Departamentin për Krime të Rënda gjithsej (7) kërkesa për sekuestrim Në Departamentin e Përgjithshëm, gjithsej (6) kërkesa për sekuestrim</p>

4	<p>Objektivi 4: Zvogëlimi i numrit të lëndëve në Prokurorinë e Shtetit. Komento:</p> <p>Prokuroria Themelore në Prishtinë ka të krijuara njësite të specializuara brenda strukturës së saj, në të cilat janë të angazhuar prokurorë të profilizuar në trajtimin e rasteve me natyrë më specifike siç janë krimet ekonomike, korrupsioni si dhe rastet e dhunës në familje. Kjo formë e organizimit bën që rastet e tilla të përfundohen më shpejtë dhe iu jepet rëndësia maksimale.</p>
5	<p>Objektivi 5: Vlerësimi i rrezikut dhe planifikimi i vazhdimësisë së punës në pandemi. Komento:</p> <p>Nuk ka të dhëna për këtë indikator.</p>
6	<p>Objektivi 6: Administrimi efikas, llogaridhënia dhe rritja e profesionalizimit. Komento:</p> <p>Është thelluar bashkëpunimi me Policinë e Kosovës ashtu që përmes takimeve të rregullta kemi përmirësuar dukshëm bashkëpunimin dhe kemi arritur në ngritjen e profesionalizmit dhe mënjanimin të pengesave.</p> <p>Më tutje përmes komunikatave vazhdimisht kemi njoftuar publikun për trajtimin e rasteve brenda Kompetencave të lejuara për dhënien e informatave në çdo fazë të procedurës penale konform dispozitave ligjore.</p> <p>Vazhdimisht është kërkuar nga prokurorët raporte javore , mujore, tremujore gjashtëmujore, duke përfshirë njoftime lidhur me trajtimin e lëndëve, duke kërkuar që në mënyrë të vazhdueshme të përmirësojnë përpilimin e shkresave, vendimeve e ankesave të dërguara si në gjykatë ashtu edhe në Institucione të tjera.</p> <p>Për këtë periudhë përmes Udhëheqësve të departamenteve nga prokurorët kemi kërkuar raporte lidhur me prioritetet në lëndë në baza tre mujore.</p> <p>Gjithashtu sa i përket lëndëve të Njësitit për Krime Ekonomike dhe Korrupsion kemi shkuar te çdo prokuror për të parë veprimin e fundit dhe datën e veprimit të fundit për secilën lëndë.</p>
7	<p>Objektivi 7: Aplikimi më efikas i proceduarave alternative në zgjidhjen e rasteve penale. Komento:</p> <p>Gjatë kësaj periudhë raportuese Kryeprokurori ka mbajtur takim me prokurorët dhe të njëjtit i ka udhëzuar që sa më shumë ti aplikojnë procedurat alternative, në këtë drejtim ka mbajtur takim edhe me dy referentet e ndërmjetësimit nga të cilat ka kërkuar që të jenë më efikase në trajtimin e këtyre rasteve. Pas takimit me Kryeprokurorin të njëjtat janë takuar me të gjithë prokurorët me radhë dhe kanë diskutuar se cilat lëndë janë të përshtatshme të i nënshtrohen kësaj procedure.</p> <p>Gjithashtu është mbajtur edhe takim me Ambasadën Amerikane- programi i financuar nga International Narcotics and Law Enforcement Affairs (INL), Programi i Ndërmjetësimit.</p> <p>Po ashtu Kryeprokurori ka organizuar takim me referentet e ndërmjetësimit në kuadër të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.</p>
8	<p>Objektivi 8: Bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar i Prokurorit të Shtetit. Komento:</p> <p>Edhe në këtë periudhë kujdes të veçantë i është kushtuar rasteve me kërkesa ndërkombëtare, duke ndarë si përgjegjësi shtesë për zyrën e kryeprokurorit që çdo kërkesë e natyrës urgjente dhe të tjera t'u ndihmojë prokurorëve, të njëjtat t'i vë në pah që të trajtohen sa më shpejtë, duke ofruar ndihmë</p>

profesionale. Prokuroria Themelore Prishtinë ka të caktuar dy (2) koordinator për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtarë. Përmes këtij përkushtimi si prokurori kemi pranuar vlerësime pozitive edhe nga Institucionet e tjera.

II. KËRKESAT SPECIFIKE TË KPK-së, (për periudhën e konkrete të shenjzuar të raportimit)

1	Avancimi/transferimi i prokurorëve shtesë në DKR dhe DM.
2	
3	
4	
5	
6	
7	
8	

III. ASPEKTE ADMINISTRATIVE:

Raportimi	Periudha kohore për të cilën raportohet	Shenjzimi
I parë:	Nga 1 janar deri më 31 mars të çdo viti	
I dytë:	Nga 1 prill deri më 30 qershor të çdo viti	<input checked="" type="checkbox"/>
I tretë:	Nga 1 korrik deri më 30 shtator të çdo viti	<input type="checkbox"/>
I katërt:	Nga 1 tetor deri më 31 dhjetor të çdo viti	<input type="checkbox"/>

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka kërkuar nga Kryeprokurori që të dorëzoj raportin:	Kryeprokurori e ka dorëzuar raportin në Këshill (para raportimit):
Me datë: 18.07.2023	Me datë: 01.08.2023